



Ky projekt financohet nga  
Bashkimi Evropian



Empowered lives.  
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

## THIRRJE PËR STAF PËR INVENTARIZIMIN E LIBRAVE

**Emri:** Shoqata Shpresa për të ardhmen  
**Adresa:** Rruga Gjon Gazulli, nr. 64, Shkodër  
**E-mail:** [hopeff@hotmail.com](mailto:hopeff@hotmail.com)  
**Afati i dorëzimit të ofertës:** 14. 07. 2019, ora 16:00

Shoqata Shpresa për të ardhmen po zbaton projektin “Edhe unë e dua librin” në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Bashkia Shkodër, si një ndër 12 bashkitë partnere të Programit ReLOaD në Shqipëri, është bashkëfinancuese dhe bashkëzbatuese e programit, për projektet që po zbatohen në territorin e Bashkisë.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata do blejë libra artistikë për të cilat është i nevojshëm inventarizimi i tyre.

### **Kushtet për pjesëmarrje:**

Të gjithë personat e interesuar duhet të dorëzojnë aplikimin e tyre siç parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 14. 07. 2019, ora 16:00, në adresën e e-mailit: [hopeff@hotmail.com](mailto:hopeff@hotmail.com) ose në adresën postare: Shoqata Shpresa për të ardhmen, Rruga Gjon Gazulli, nr. 64, Shkodër

### **Përshkrimi i punës**

Personat e kontraktuar për këtë pozicion punë do kryejnë këto detyra: *Stafi do të punojë në grup për skedimin dhe inventarizimin e 1000 librave të bibliotekës në ambjentet e shoqatës Shpresa për të ardhmen. Ky shërbim do të kryhet brenda muajit korrik 2019. Datat specifike do të përcaktohen në kontratat që do lidhen me stafin.*

### **Kriteret që duhet të përmbushë eksperti për këtë pozicion:**

*Eksperti duhet të përmbushë këto kritere:*

*Të ketë arsimin e lartë në fushën e mësuesisë.*

*Të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune.*

*Të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune.*

*Të ketë eksperiencë pune në bibliotekë.*

*I komunikueshëm dhe bashkëpunues.*

*Preferohet të jetë nga Shkodra dhe të ketë eksperiencë pune me organizatat e shoqërisë civile.*



Ky projekt financohet nga  
Bashkimi Evropian



Empowered lives.  
Resilient nations.

### **Kushte të përgjithshme:**

- 1) Preferohen persona të fushës së arsimit (gjuhë – letërsi) dhe që nuk janë në marrëdhënie pune në institucionet shtetërore të Bashkisë Shkodër.
- 2) Dorëzimi i aplikimit do të bëhet vetëm nëpërmjet e-mail në adresën e organizatës Shpresa për të ardhmen brenda datës 14. 07. 2019, ora 16:00, ose në adresën postare: Shoqata Shpresa për të ardhmen, Rruga Gjon Gazulli, nr. 64, Shkodër.

### **Nuk pranohen ofertat dorazi.**

- 3) Paga e stafit do të kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit.

Në aplikimin e tij/saj, aplikuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit dhe duhet të paraqesin këto dokumenta:

- 1) CV dhe letër interesi;

Aplikantët që ofrojnë shërbimin në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohen për të nënshkruar kontratën.